



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr 2126/8 Prot.

Tiranë, më 16.09 2025

VENDIM  
Nr. 100 datë 16.09 2025  
PËR  
NËNSHKRIMIN E RINOVIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT  
NDËRMJET UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS  
DHE UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma “c” dhe nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, në nenin 20, pika “s” të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe në Vendimin e Rektoratit nr. 98 datë 11/09/2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 16/09/2025,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet **Universitetit të Sporteve të Tiranës** dhe **Universitetit të Tiranës**.
2. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në faqen zyrtare të institucionit.
3. Ngarkohet për zbatimin dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nënshkrimit Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I TIRANËS

Nr. \_\_\_\_ Prot., datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025



UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

Nr. \_\_\_\_ Prot., datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

**DHE**

**UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

**“Për vendosjen e bashkëpunimit reciprok në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve formuese për çështje me interes të përbashkët”**

---

Sot, në Tiranë, më datë \_\_. \_\_. 2025, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi midis palëve:

**Universiteti i Tiranës**, me seli në adresën Sheshi “Nënë Tereza” 4, Tiranë 1010, përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Artan HOXHA, këtu e në vijim edhe “UT”.

dhe

**Universiteti i Sporteve të Tiranës**, me seli në adresën “Muhamet Gjollësia” Tiranë 1001, përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Agron KASA, këtu e në vijim edhe “UST”.

### **Preambul:**

Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës, në vijim të quajtura Palë:

*Vlerësojnë* rëndësinë e shkëmbimeve reciproke me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe aftësive kërkimore të institucioneve nga njëra anë, dhe realizimin e trajnimeve e praktikave të punës në fusha të interesit të posaçëm;

*Afirmojnë* vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje në interesin më të mirë të secilës Palë;

*Duke u mbështetur* në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë institucionale, konkretisht, Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Universitetit të Tiranës dhe Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës

*Kanë ranë dakord* të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, këtu e në vijim “Marrëveshje”.

### **Neni 1 Objekti**

Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës, si dhe strukturat a njësitë përbërëse të tyre, brenda fushës së përgjegjësisë, të detyrave dhe funksioneve që u ngarkohen nga ligjet në fuqi, dakordësojnë, përmes kësaj Marrëveshjeje, realizimin e një bashkëpunimi didaktik shkencor e më gjerë për çështje me interes të përbashkët.

## **Neni 2**

### **Fushat e bashkëpunimit**

Palët, për realizimin e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, shprehin gatishmërinë për të bashkëpunuar së bashku për hartimin, aplikimin dhe/ose zbatimin e projekteve të përbashkët, si edhe për zhvillimin e çdo lloj veprimtarie apo aktiviteti tjetër të nevojshëm.

1. UT dhe UST, kryesisht do të bashkëpunojnë:

- a) për hartimin dhe aplikimin në Projekte kombëtarë dhe ndërkombëtarë, kryesisht të financuar nga BE, si: Erasmus +, Horizon 2020 etj, për të cilët do të kërkohet përfshirja e stafit akademik, stafit drejtues dhe studentëve të palëve në zbatim të këtyre projekteve;
- b) për organizimin e aktiviteteve të përbashkët, - debate, konferenca, simpoziume, ëorkshope;
- c) për zhvillimin dhe përmirësimin e praktikave profesionale në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve;
- d) për shkëmbimin dhe përdorimin e literaturës shkencore dhe platformave online, etj.
- e) Ngritjen e komisioneve të përherëshme të përbashkëta për “Promovimin e Personelit Akademik” si dhe ngritjen e “Komisioneve për Dhënien e Gradës Doktor”.
- f) për shkëmbimin e informacionit, materialeve akademikë dhe publikimeve në fusha të interesit të ndërsjellë;
- g) për krijimin e programeve të përbashkët të studimit;
- h) për shkëmbimin e studiuesve dhe shkencëtarëve për të kryer kërkime me interes të ndërsjellë.
- i) Shkëmbimin e personelit akademik/administrative dhe studentëve;
- j) udhëheqje doktoratash të përbashkëta;
- k) organizim të shkollave verore/dimërore;
- l) aktivitete në ndërtimin e kapaciteteve;
- m) krijimi i një rrjeti për shkëmbime të përvojës në tematika të ndryshme.

2. Palët, me qëllim përmbushjen me sukses të tyre, do të diskutojnë paraprakisht mbi mënyrën dhe organizimin e veprimtarive të përbashkëta të parashikuara në pikën 1 të kësaj Marrëveshjeje, si edhe të bashkëpunimeve, projekteve apo aktiviteteve të tjerë të përbashkët.

### **Neni 3**

#### **Detyrimet e Palëve**

2. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët marrin përsipër sa vijon:

- a) Vënien në dispozicion të mjediseve që disponohen nga secila Palë në funksion të organizimit të aktiviteteve të përbashkëta;
- b) Mbështetjen e kërkimit shkencor, nëpërmjet mundësisimit të aksesit në informacionin apo të materialeve didaktike dhe studimore, që disponohen nga secila Palë.
- c) Pala përfituese do të vendosë në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe logjistike për organizimin e aktiviteteve në dobi dhe me kërkesë të saj.
- ç) Palët marrin përsipër të sigurojnë pjesëmarrjen në aktivitetet e përbashkëta apo në ato të organizuara me kërkesë të njërës Palë.

### **Neni 4**

#### **Zbatimi**

Nëse të dyja Palët zgjedhin të hyjnë në një bashkëpunim kërkimor, palët do të diskutojnë me vullnet të mirë kushtet dhe termat e një marrëveshjeje të tillë dhe do të përpiqen të arrijnë një marrëveshje të pranueshme reciproke për të rregulluar bashkëpunimin kërkimor, duke përfshirë kushtet e financimit, përmbajtjen dhe pronësinë intelektuale të krijuar gjatë kërkimit.

Ky dokument nuk ka për qëllim të krijojë detyrime ligjore ose të detyrueshme për ndonjë palë. Ai shpall qëllimet aktuale të Palëve për të përmirësuar marrëdhënien e të dy institucioneve për të ardhmen.

Para se të zbatohet ndonjë nga aktivitetet e përcaktuar në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, Palët duhet të hyjnë në marrëveshje me njëra-tjetrën, që do të përshkruajnë formën dhe përmbajtjen specifike të aktiviteteve dhe do të trajtojnë përgjegjësitë dhe të drejtat e secilës Palë për ato aktivitete. Palët bien dakord të negociojnë termat e çdo marrëveshjeje të tillë në mënyrë të mirë dhe për qëllimin e përmirësimit të marrëdhënieve të Institucioneve.

### **Neni 5**

#### **Personat e kontaktit**

Me qëllim lehtësimin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, secila palë cakton personat e kontaktit:

**Për UT:**

*Spektori i Marrëdhënieve me Jashtë:*

[iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al);

+35542250166

**Për UST:**

*Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikut*

[sshabanaj@ust.edu.al](mailto:sshabanaj@ust.edu.al);

+355 674091443

## **Neni 6**

### **Burimet Financiare**

Partnerët bien dakord që të gjitha marrëveshjet financiare të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për Bashkëpunim ose çdo marrëveshje tjetër të mëpasshme duhet të negociohen sipas rregulloreve të secilit universitet dhe të varen nga disponueshmëria e fondeve. Palët pranojnë që kjo Marrëveshje Bashkëpunimi krijon një bazë mirëkuptimi dhe interesi të ndërsjellë dhe nuk përfshin ndonjë detyrim financiar për secilin universitet.

## **Neni 7**

### **Të drejtat e autorit**

Përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe dhe sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, çdo pronë e re intelektuale e krijuar si pasojë e kësaj Marrëveshjeje, normalisht do të jetë në pronësi të palës që e krijon atë, megjithëse për çdo ndryshim do të ketë hapsirë për të negociuar sipas rastit.

## **Neni 8**

### **Konfidencialiteti dhe ruajtja e të dhënave**

1. Palët kanë të drejtë të kërkojnë që përmbajtja e kësaj Marrëveshjeje dhe të dhënat personale të pjesëmarrëve në aktivitetet e përbashkëta, të ruhen dhe trajtohen si konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Palët angazhohen që, gjatë përpunimit të të dhënave personale, të marrin të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e tyre, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.
3. Detyrimet e mësipërme për ruajtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetit të të dhënave, shtrihen edhe mbi nëpunësin publik, gjatë edhe pas përfundimit të Marrëveshjes.

## **Neni 9**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë mes Palëve lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet mes palëve me mirëkuptim dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 10**  
**Kohëzgjatja**

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një **afat 5 (pesë) vjeçar**, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj, dhe rinovohet automatikisht për një periudhë tjetër dy vjeçare, me përjashtim të rastit kur njëra nga Palët njofton vullnetin e saj për zgjidhjen e Marrëveshjes.

**Neni 11**  
**Dispozita të fundit**

1. Secila palë merr përsipër njohjen e strukturave të varësisë me detyrimet e kësaj Marrëveshjeje, si dhe respektimin e zbatimin e detyrimeve që rrjedhin prej saj.
2. Në rast mospërbushjeje të detyrimeve të mësipërme, secila Palë informon titullarin e institucionit.
3. Çdo aneks, ndryshim a shtesë Marrëveshjeje i nënshkruar nga Palët në të ardhmen, në bazë dhe për zbatim të kësaj Marrëveshjeje, do të konsiderohet si pjesë përbërëse e saj.
4. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga Palët.
5. Marrëveshja përgatitet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, të hartuar nga palët në vullnet të lirë e të plotë, me të njëjtën përmbajtje dhe formë, një prej të cilave depozitohet në Universitetin e Tiranës dhe një në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

**UNIVERSITETI I TIRANËS**

**REKTORI**

**Prof. Dr. Artan HOXHA**

**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**

**REKTORI**

**Prof. Dr. Agron KASA**